



Nr 1185 Prot dt. 26.10.2023

Nr 110 Prot dt. 26.10.2022

**Komisioneri për
Mbrojtjen nga Diskriminimi
Adresa: Rr.Durrësit nr 27 Tiranë**

**Fondacioni JOSCELYN
Adresa Rr. Mefail Biçaku
Elbasan**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Dhe

Fondacioni JOSCELYN

Lidhur sot më 26.10.2023, në Tiranë ndërmjet:

Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësuar nga Z. Robert Gajda, me adresë Rruga e Durrësit, nr.27, Tiranë, këtej e tutje e cilësuar si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

dhe

Fondacioni JOSCELYN, përfaqësuar nga Z. Saimir Bakalli, me adresë: Rr. "Mefail Biçaku" L."28 Nëntori", Elbasan, këtej e tutje e cilësuar si Organizata.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Fondacioni JOSCELYN kanë një eksperiencë dhe përvojë të gjatë në garantimin e zbatimit dhe realizimit të misioneve të përbashkëta në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dëshirojnë që të çojnë përpara bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet tyre në këtë fushë, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, për sa më poshtë:

**NENI 1
OBJEKTI**

Kjo marrëveshje ka për objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Fondacioni Joscelyn do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të bashkëpunimit të ndërsjelltë, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm.

NENI 2 QËLLIMI

Realizimi i veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për promovimin e sipërmarrjes sociale “Tradita ime Artizanale”, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut; angazhimin institucional të të gjithë aktorëve; rritja e bashkëpunimit në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, të transparencës dhe të llogaridhënies; si dhe ndërhyrjen pozitive të institucioneve shtetërore sa herë që është e nevojshme, promovimin e praktikave të mira të lidhura me ndalimin e diskriminimit.

NENI 3 ANGAZHIMET E PALËVE

Nëpërmjet kësaj marrëveshje palët angazhohen:

- Të bashkëpunojnë mbi çështje me interes të përbashkët sic është promovimi i sipërmarrjes sociale “Tradita ime Artizanale”.
- Të përfshihen nëpërmjet angazhimit institucional të përbashkët për ndryshime ligjore që lidhen me fushat me interes të përbashkët.
- Të njoftojnë njeri-tjetrin mbi raste konkrete që kërkojnë trajtim institucional.
- Të organizojnë aktivitete si dhe eventeve të përbashkëta, apo të ftojnë për pjesëmarrje në aktivitete që palët organizojnë.
- Të përfshihen në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e edukimit mbi sipërmarrjen sociale, informimit të komunitetit dhe të rinjve që studiojnë në nivel para universitar dhe universitar.
- Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e fushatave të përbashkëta sensibilizuese dhe trainimeve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen nga diskriminimi, minimizimin e rasteve të diskriminimit.
- Palët angazhohen të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë ekspertize për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim përfshirjen e masave të reja që garantojnë trajtimin e barabartë dhe eliminimin e parashikimeve diskriminuese nga legjislacioni aktual në fushat e (rome-egjiptiane, persona me aftësi të veçanta, studentët, të rinjtë, fëmijët, emigrantët, të burgosurit, punëmarrësit, besimtarë, banorët e lokaliteteve periferike, etj), nëpërmjet propozimeve dhe rekomandimeve në funksion të mbrojtjes së tyre.
- Palët do të informojnë njëra-tjetrën mbi çdo lloj shërbimi që ata do të ofrojnë në të ardhmen në bashkëpunim dhe mbi çdo gjë tjetër që do të gjykohet e nevojshme për një bashkëpunim të frytshëm midis palëve të kësaj marrëveshjeje.

- Palët angazhohen të mbështesin njëra tjetrën në realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok, të lidhura ngushtë me objektin e veprimtarive respektive.
- Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen, ndaj lista e mësipërme nuk është e natyrës shteruese.

NENI 4 KOMUNIKIMI NDËRMJET PALËVE

- Palët angazhohen të mblidhen në mënyrë periodike, sa herë të gjykohet e nevojshme, por jo më rrallë se një herë në 6 muaj.
- Palët do të caktojnë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret edhe në rrugë operacionale të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, si dhe për shkëmbimin e informacionit lidhur me të.
- Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë një informacion të rëndësishëm dhe urgjent për t'u përcjellë, komunikimi mund të bëhet dhe në mënyrë elektronike dhe verbale, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

NENI 5 KOHËZGJATJA

- Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një afat të pacaktuar dhe ajo do të jetë efektive për sa kohë do të gjykohet si i nevojshëm dhe i domosdoshëm bashkëpunimi midis palëve.
- Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes, duke njoftuar me shkrimpalën tjetër 60 ditë para.

NENI 6 DISPOZITA TË FUNDIT

- Marrëveshja mund të ndryshohet, të amendohet vetëm me pëlqimin e ndërsjelltë të palëve dhe në mënyrë shkresore.
- Paqartësitë apo konfliktet që mund të lindin gjatë zbatimit të marrëveshjes do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve, duke bërë përpjekje konkrete për zgjidhjen e situatës.
- Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, nënshkruhet dhe protokollohet nga çdo palë. Secila nga palët mban një kopje origjinale.
- Marrëveshja hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga palët.



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI

FONDACIONI JOSCELYN

KOMISIONER

DREJTORI EKZEKUTIV

ROBERT GAJDA

SAIMIR BAKALLI

